

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Prizrenit 2012

Korrik, 2012

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”. Debati në “Jeta në Kosovë” për Komunën e Prizrenit është transmetuar në RTK më 19 korrik 2012.

Përmbajtja:

1. Hyrje.....	3
2. Pesë problemet më të mëdha të identifikuar gjatë fushatës elektorale 2009...	3
2.1. Mungesa e ujit të pijes	4
2.2. Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore	5
2.3. Mungesa e vend parkingjeve	5
2.4. Kanalizimi dhe ujërat e zeza	6
2.5. Mungesa e ciceronit turistik	6
3. Performanca buxhetore e Komunës së Prizrenit.....	6
3.1. Investimet kapitale.....	8
3.2. Menaxhimi me paranë publike	10
4. Arsimi	15
5. Shëndetësia	16
6. Administrata komunale	16
7. Transparenca dhe ligji për vetëqeverisje lokale.....	17
8. Puna e Kuvendit Komunal	18
9. Premtimet zgjedhore dhe realizueshmëria e tyre	21
10. Burimet	24

1. Hyrje

Komuna e Prizrenit ndodhet në juglindje të Kosovës. Ajo mbulon një sipërfaqe prej rreth 284/km² dhe përfshin qytetin e Prizrenit dhe 74 fshatra. Ka afër 180 mijë banorë dhe është komuna e dytë më e madhe për nga numri i popullsisë në Kosovë.

Numri i përgjithshëm i votuesve në komunën e Prizrenit të regjistruar për zgjedhjet e fundit komunale të mbajtura në nëntor të vitit 2009 ishte 144.579, duke përfshirë ata edhe jashtë Kosovës. Pjesëmarrja e votuesve ishte 45,38 për qind apo 61.777 votues sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komuna e Prizrenit drejtohet nga kryetari Ramadan Muja (PDK) dhe dy nënkryetarë, i pari Ruzhdi Rexha dhe ai për komunitete Orhan Lopar. Qeveria komunale përbëhet nga 13 drejtori: Administrata, Buxhet dhe Financa, Inspektorati, Shërbimet Publike, Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Gjeodezi dhe Kadastër, Arsimi dhe Shkenca, Shëndetësi, Zhvillimi i Turizmit, Emergjencia dhe Siguria, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Kulturë, Rini dhe Sport.

Në zgjedhjet e fundit komunale në Prizren, kryetar komune pas raundit të tretë (balotazh) është zgjedhur kandidati i PDK-së, Ramadan Muja dhe njëherësh partia e tij ka fituar shumicën e ulëseve në Kuvendin Komunal duke formuar koalicionin qeverisës në nivel lokal. Në këtë mënyrë qytetarët e komunës së Prizrenit i kanë besuar Z. Mujës mandatin e dytë qeverisës.

2. Pesë problemet më të mëdha të identifikuar gjatë fushatës elektorale 2009

Në prag të fushatës zgjedhore 2009, Instituti GAP kishte zhvilluar një anketë me banorët e komunës së Prizrenit për të identifikuar pesë problemet kryesore me të cilat përballet kjo komunë.¹ Nga kjo anketë kishte rezultuar se pesë problemet më të mëdha të kësaj komune ishin:

1. Uji i pijshëm
2. Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore

¹ Instituti GAP. "Prizreni – Raporti Komunal 2009. Nëntor 2009. Burimi: http://institutigap.org/repository/docs/PRIZRENI-RAPORTI_KOMUNAL.pdf

3. Mungesa e vend parkingjeve
4. Kanalizimet dhe ujërat e zeza
5. Mungesa e ciceronit turistik.²

2.1. Mungesa e ujit të pijes

Mungesa e ujit të pijshëm është një ndër problemet më të mëdha me të cilin janë ballafaquar për vite të tera qytetarët e komunës së Prizrenit. Mungesa e ujit është problem jo vetëm për qytetin por edhe për fshatrat e kësaj komune. Por, përderisa nëpër fshatra, sidomos ato të anës së Hasit, banorët ia dalin me anë të puseve, banorët e qytetit varen kryekëput nga ujësjellësi. Fajin për mungesë të ujit qytetarët ia lënë komunës, e në veçanti ujësjellësit të qytetit 'Hidrogjeni Jugor' i cili fajësohet për keq menaxhim.

Pjesët më të prekura të qytetit nga ky problem janë ato në periferi. Në lagjen "Arbana" ka shumë pak ujë gjatë ditës, kurse në lagjen "Tusus" reduktimet janë tejet të gjata. Sa i përket burimeve të ujit, qytetarët përmendin burime uji që mund të sillëshin në Prizren me pak përkushtim të komunës. Në fshatin Vermicë, 12 km larg nga Prizreni, ata thonë se ekzistojnë dy burime që do të mund të furnizonin një pjesë të madhe të komunës me ujë. Burim tjetër konsiderohet të jetë ai në kodrën e quajtur Cylen. Vjetërsia e gypave të sistemit të ujësjellësit jo vetëm që humb sasi uji por është rrezik që ujërat e zeza të depërtojnë në gypa të tillë.

Zgjidhja e problemit me ujë të pijshëm është dashur të jetë një nga prioritetet e pushtetit të lokal të zgjedhur më 2010. Në të vërtetë, në zgjedhjet e vitit 2009, Z. Muja pat premtuar furnizim 24 orë me ujë, gjë që nuk është realizuar përkundër faktit se komuna ka ndarë mjete nga buxheti komunal për investime në gjetjen e burimeve të reja të ujit të pijes. Vetëm gjatë vitit 2011 Komuna ka shpenzuar gjithësej 291.440 euro për ujësjellës, kryesisht në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellist në disa fshatra të Prizrenit. Megjithatë edhe sot qytetarët e Prizrenit si ata në periferi ashtu edhe ata brenda qytetit ballafaqohen me reduktime të mëdha të ujit.

² Gjatë intervistave me qytetarë, si probleme më madhore ishin potencuar problemet si: papunësia, rrjeti dobët i energjisë elektrike, varfëria, etj. Mirëpo në raportin e GAP të 2009 këto probleme nuk janë listuar për arsye se zgjidhja e këtyre problemeve nuk është kryesisht në kompetencë të kryetarit të komunës. Andaj në këtë listë prej pesë problemeve figurojnë vetëm ato probleme të cilat mund të zgjidhen me anë të punës së kryetarit të komunës.

2.2. Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore

Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore ka qenë brengë e qytetarëve të Prizrenit e shprehur më 2009. Prizreni konsiderohet si qytet i vjetër me monument të lashta të cilat duhet të ruhen. Pjesa e vjetër e qytetit që quhet si Zona I dhe Zona II, mbrohet edhe me ligj. Por viteve të fundit është parë një degradim urban i kësaj zone të mbrojtur, në zemër të së cilës gjendet edhe qendra e qytetit, Shadervani. Aty sot janë ndërtuar objekte pronarët e të cilave shpesh i kanë ikur planit dhe kanë ndërtuar sipas dëshirës. Inspektorët nuk e kanë kryer punën e tyre.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore ishte njëherit edhe premtim i Kryetarit Muja në zgjedhjet e vitit 2009. Por, dështimi i ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Prizren ka imponuar edhe miratimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit më 2011, i kundërshtuar nga qytetarët dhe shoqëria civile. Kryetari Muja asnjëherë nuk ka paraqitur një qëndrim publik rreth shqetësimeve të shprehura nga qytetarët dhe shoqëria civile. Ndërtimet pa leje dhe uzurpimet në qendrën historike të Prizrenit dëshmojnë për dështimin e pushtetit lokal në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

2.3. Mungesa e vend parkingjeve

Një qytet që ka një rritje të dukshme të popullatës dhe një numër turistësh që e vizitojnë Prizrenin çdo ditë. Kjo shton nevojën edhe më shumë për më tepër hapësira për parkingje. Mungesa e vend parkingjeve publike mbetet preokupim tjetër i qytetarëve të kësaj komune. Shpesh ndodh që qytetarët t'i shkojnë rreth e qark qytetit në rrugën një kahëshe në kërkim të një vend parkingu. Në qytetin e Prizrenit në përgjithësi mund të vërehen investime nëpër rrugë, por vend parkingjet janë lënë anash krejtësisht. Asnjëherë nuk është marrë seriozisht nga kandidatët për kryetar komune zgjidhja e këtij problemi.

Sot disa nga vend parkingjet ekzistuese janë biznese privat. Në mungesë të parkingjeve publike, qytetarët detyrohen ose të paguajnë në ato private ose të parkojnë veturat kudo, shpesh duke bllokuar rrugë dhe shkaktuar rrëmujë në komunikacion.

2.4. Kanalizimi dhe ujërat e zeza

Përgjatë lumit Lumbardhë lehtë mund të vërehen gypa të mëdhenj që derdhen kanalizimet në lum. Këto ujëra të zeza grumbullohen nga lagje të tëra dhe më pas derdhen në lum. Mungesa e ujit në lum në disa pjesë të vitit ka bërë që ujërat e zeza të kundërmojnë dhe lëshojnë aromë jo të këndshme për kalimtarët. Kjo i jep një pamje shumë të rëndë qytetit, qendra e të cilit ndodhet mu pranë lumit. Kjo aromë ia zbeh imazhin edhe 'Urës së Gurit' si dhe urave tjera mbi këtë lum që janë atraksion për shumë vizitorët. Për t'ia prishur edhe më shumë pamjen këtij qyteti janë edhe mbeturinat e hedhura kudo, qoftë për mungesë të kontejnerëve apo hedhjes përreth tyre si dhe mos pastrimit të tyre me kohë.

Në zgjedhjet e vitit 2009 z. Ramadan Muja kishte premtuar edhe rregullimin e shtratit të lumit. Më saktësisht, në fushatën zgjedhore ishin premtuar 25 milionë euro investime për lumin Lumbardhë. Deri më tani vetëm një projekt 350 mije eurosh është realizuar dhe atë fal investimeve të MMPH-së. Komuna nuk ka bërë asgjë në drejtim të rregullimit të shtratit të lumit.

2.5. Mungesa e ciceronit turistik

Edhe pse qyteti i Prizrenit njihet për trashëgimi kulturor, qytetit i mungon një qendër për turistët e cila përveç hartës së qytetit do të siguronte edhe ciceronin e qytetit. Me gjithë pikat e shumta turistike që ka qyteti, vizitorët e huaj shpesh duhet t'i gjejnë vet ato pika për t'i eksploruar. E vetmja hartë turistike është ajo e vendosur pranë urës së gurit, që do të thotë se turistit i duhet të shkoj deri aty për t'u orientuar për me tutje. Shenja orientuese mungojnë edhe në hyrje të qytetit.

3. Performanca buxhetore e Komunës së Prizrenit

Buxheti total i Komunës së Prizrenit për vitin 2011 ishte 32.949.270 euro, ndërkaq Komuna kishte arritur që ta shpenzojë buxhetin në masën prej 95 për qind. Buxheti i vitit 2011 është dukshëm më i madh se ai i vitit 2010 (i cili ishte 27.728.324 euro).

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në raportin vjetor të Auditimit 2010 kishte identifikuar dobësi dhe mangësi menaxheriale, për çka edhe i kishte dhënë komunës 10

rekomandime. Mirëpo, Komuna kishte adresuar vetëm 2 rekomandime dhe 8 të tjera nuk ishin adresuar fare. Kështu edhe në raportin e Auditimit 2011, shumë nga ato vërejtje ishin përsëritur. Një ndër vërejtjet e Auditorit është se Komuna nuk kishte arritur ta harmonizojë plotësisht buxhetin me dinamikën e shpenzimeve në periudha kohore. Nga totali i shpenzimeve buxhetore, 32 për qind ishin shpenzuar në tre muajt e fundit të vitit. Shkelje tjetër është me datë 01/03/2011 kur Komuna ka ripërtërirë një kontratë qiraje me operatorin "Sharbegu" për shfrytëzimin e pronës publike për një periudhe njëvjeçare. Qiraja mujore ishte caktuar 800 euro për muaj. Kontrata ishte ripërtërirë, edhe pse qiramarrësi sipas kushteve të kontratës, nuk kishte paguar shumën e mbetur nga kontrata e vjetër prej 3.201 euro.³ Sfiduese mbetet edhe kontrollimi dhe menaxhimi i të hyrave vetanake, për faktin se me gjithë numrin e madh të bizneseve që operojnë në Komunën e Prizrenit si dhe numrin e madh të qytetarëve që paguajnë taksa komunale, regjistrim i të hyrave në kode jo përkatëse rezulton me raportimin e gabueshëm të tyre.

Sa i përket prokurimit, Raporti i Auditorit nxjerr në pah shkelje serioze të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Te kontrata e lidhur më datën 29/04/2011 - Furnizim me artikuj ushqimor për invalidët e luftës, është vërejtur se së pari janë pranuar artikujt ushqimor, ndërsa procedurat e prokurimit janë kryer më vonë. Vlera e kontraktuar dhe e shpenzuar për këto artikuj ushqimor ishte 13.642 euro. Furnizuesi i artikujve ushqimor ishte DPT "Mak Pilar". Rasti tjetër është kur gjatë vitit 2011 komuna kishte lidhur me një kompani private katër kontrata për t'i ofruar shërbime profesionale të konsulencës në ofrimin e praktikantëve në komunë, në vlerë prej 48.630 euro. Mirëpo edhe pse pagesa ishte bërë për ofrimin e shërbimeve profesionale të konsulencës, Auditorit nuk i është ofruar asnjë dëshmi se kujt iu kanë ofruar këto shërbime. Problem tjetër që është vërejtur nga Auditori është se shumica e projekteve të cilat kishin filluar gjatë vitit 2010, ishin përfunduar gjatë vitit 2011. Për këto vonesa në asnjë rast komuna nuk ka aplikuar masa penale apo ndëshkime tjera.

Çështja e borxheve të papaguara vazhdon të jetë një shqetësim tejet i madh sa i përket financave të komunës së Prizrenit. Bazuar në Raportin financiar të vitit 2011 të Buxhetit të Republikës së Kosovës; qeveria komunale e Prizrenit është specifikuar si organizatë buxhetore me më së shumti borxhe dhe si e tillë faturat e pa paguara arrijnë shumën prej 3.164.000 euro në fund të vitit fiskal 2011, ndërsa për vitin 2010 qeveria lokale e Prizrenit kishte fatura të pa paguara prej 2.894.450 euro. Në këtë dokument Komuna e

³ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm – Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Prizrenit pasqyrohet si ndër komunat që ka më së shumti fatura të pa paguara (borxhe).⁴ Duke marrë për bazë borxhet prej mbi 3 milionë euro financat e komunës së Prizrenit nuk janë shpresëdhënëse, meqenëse kohë më parë është aprovuar vendimi për marrjen e kredisë për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në fshatin Vlashnje, në vlerë prej 3 milionë eurosh, që e çon nivelin e detyrimeve në 6 milionë euro, përderisa plani vjetor për investime kapitale është rreth 12 milionë euro.

Drejtuesit e Prizrenit nuk janë shquar as për kursim të pozicionit buxhetor mallra dhe shërbime. Shpenzimet e udhëtimit në vitin 2010 kanë qenë 110 mijë euro dhe në vitin 2011 – 74 mijë euro. Për derivate dhe lëndë djegëse në vitin 2010 janë shpenzuar 717 mijë euro dhe në vitin 2011 - 713 mijë euro.⁵ Shpenzimet e reprezentacionit në vitin 2010 kanë qenë 84 mijë euro dhe në vitin 2011 – 91 mijë euro.

3.1. Investimet kapitale

Qeveria komunale ka bërë edhe investime kapitale të pamenduara mirë e që i kanë kushtuar shtrenjtë buxhetit komunal. Furnizimi me binë profesionale për koncerte me pajisje tjera përcjellëse ka kushtuar 110 mijë euro, ndërkohë që komuna nuk ka depo të posaçme për vendosjen e tyre. Këto pajisje ekstra të shtrenjta që nga opozita janë cilësuar si “deponi bine e zërimi” janë të vendosura në objektin e Shtëpisë së Bardhë, në zyrat që është dashtë t’i dedikohen partive të përfaqësuara në KK. Arsyetimi i kreut të komunës, Ramadan Muja për këtë investim dhënë në media ka qenë se gjatë vizitës në Osijek ai ka parë këso bine dhe ka vendosur që edhe Prizreni ta ketë të njëjtin.⁶

Kryetari Muja asnjëherë nuk ka prezantuar një strategji të zhvillimit ekonomik lokal. E vetmja platformë mbi të cilën është bazuar qeverisja ka qenë plani afatmesëm buxhetor, ku pozicionet për investime kapitale shpesh herë janë ndryshuar.

Hiç më pak se 230 euro për orë, ka paguar Komuna e Prizrenit për heqjen e borës nga rrugët dhe trotualet e këtij qyteti. Kjo praktikë e heqjes së borës me orë nuk është praktikuar ndonjëherë nga institucion që merr para nga arka e shtetit. Tenderin për zonën e parë, komuna i ka dhënë kompanisë “Çlirimi” nga Prizreni. Kjo kompani

⁴ KDI - Raporti mujor i monitorimit të punës së kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit për muajin prill 2012.

⁵ <http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/6870a9f2-3d10-4600-8a54-1aac340f1ed3/Raporti-Vjetor-Financiar-per-vitin-e-perfunduar-me.aspx>

⁶ <http://www.zeri.info/artikulli/2/8/43002/9-milione-euro-per-rruge-te-pakalueshme/>

vetëm për fshirjen dhe larjen e rrugëve nga komuna do të marrë hiq më pakë se 12.236 euro në muaj, për mirëmbajtjen e hapësirës publike, kompania do të marrë nga komuna 2.621 euro në muaj, për largimin e borës 150 euro për orë, dhe për mbjellje të barit 46 euro për njësi. Për zonën e dytë, komuna e ka shpallur fitues kompaninë “Shërbimi”, e cila nga komuna do të marrë hiq më pak se 19.111 euro në muaj për fshirjen dhe larjen e rrugëve, 798 euro për mirëmbajtjen e hapësirave publike, 40 euro në orë për largim të borës dhe 41.5 euro për mbjellje të barit për njësi. Ndërkaq, pjesën e tretë të tenderit sipas dosjes e ka fituar kompania “Ekoregjioni”, e cila për fshirjen dhe larjen e rrugëve nga komuna do të marrë 10.730 euro në muaj, për mirëmbajtjen e hapësirave publike 505 euro në muaj, largimin e borës 40 euro për orë, mbjelljen e barit 41.5 euro për njësi dhe për shërbime tjera komunale kjo kompani do të marrë nga komuna 4.900 euro në muaj.⁷

Grupi i ekspertëve për çështjet e infrastrukturës të degës së LDK-së në Prizren ka akuzuar udhëheqësit komunal për keqpërdorim të detyrës zyrtare në tenderin për ndërtimin e rrugës së fshatit Serbicë e Poshtme, projekt ky që sipas opozitarëve mban 'erë' korrupsioni. Përfaqësuesit e këtij subjekti opozitar kanë theksuar se çmimi i tenderit, përcaktimi i fituesit dhe procedurat e ndjekura çojnë në dyshimin e bazuar se bëhet fjalë për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe korrupsion, në projektin dy kilometrash që kushton 960.000 euro.

Mos pagesa e faturave të rrymës të shpenzuara për ndriçimin publik në qytet nga ana e komunës së Prizrenit ka detyruar Korporatën Energjetike të Kosovës që të merr masa për shkyçje, duke lënë në errësirë lagje të tëra gjatë disa muajve të 2012-ës. Ri-kyçja e shtyllave të ndriçimit publik në rrjetin e furnizimit elektrik sipas zyrtarëve të kësaj korporate mund të bëhet vetëm pas shlyerjes së borxheve në vlerë mbi 100.000 euro.

Nga buxheti i vitit 2011, Komuna e Prizrenit ka shpenzuar gjithsej 11,424,036.17 për shpenzime kapitale në kategoritë e listuara më poshtë.

Tab.nr.1: Disa nga investimet kapitale në Komunën e Prizrenit - 2011

Viti	Shpenzimet kapitale	Shuma (euro)
2011	Ndërtesa administrative afariste	209,611.22
2011	Objekte kulturore	635,993.65
2011	Objekte sportive	342,775.10

⁷ <http://www.zeri.info/artikulli/2/8/43002/9-milione-euro-per-rruge-te-pakalueshme/>

2011	Ndërtim i rrugëve	7,612,223.53
2011	Ndërtim i trotuareve	37,451.20
2011	Kanalizim	316,287.91
2011	Ujësjetllës	291,440.15
2011	Furnizim me rrymë	44,979.08
2011	Mobilje	5,000.00
2011	Kompjutera	12,217.00
2011	Pajisje të tjera	12,252.76
2011	Automjete	80,800.00
2011	Kapital tjetër	1,733,004.57
	Total	11,424,036.17

3.2. Menaxhimi me paranë publike

Qeveria e udhëhequr nga kryetari Ramadan Muja është shquar për joefikasitet dhe në disa raste madje edhe për veprime në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet tjera të aplikueshme. Si pasojë, Kryetari, Kryesuesi i KK dhe disa drejtorë janë hetuar nga prokuroria, dhe janë iniciuar edhe procedura gjyqësore. Asnjëri prej tyre nuk e ka marrë parasysh aktin e dorëheqjes si veprim moral. Përkundrazi kanë vazhduar me qeverisje jo transparente, shpenzime të pakontrolluar të parasë publike, mënyrë autokratike të veprimit, por edhe kërcënim të gazetarëve gjatë punës së tyre. MAPL ka pas raste kur ua ka tërhequr vërejtjen autoriteteve komunale të Prizrenit për vendimet e paligjshme.

Dobësitë e identifikuar në kuadër të Raportit të Auditorit të Përgjithshëm 2010¹ në lidhje me kualitetin e informatave, realizimin e buxhetit, sistemin e prokurimit publik, menaxhimin e detyrimeve dhe menaxhimin të pasurive tregojnë se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit brenda komunës së Prizrenit. Shumë nga këto vërejtje janë përsëritur edhe në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm 2011. Sipas këtij raporti (2010) investimet për projekte kapitale nuk menaxhohen në mënyrë efikase dhe transparente. Kontrollat e brendshme të komunës nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme se procedurat e prokurimit zbatohen në pajtim me kërkesat ligjore.⁸ Dështimet në zbatimin dhe kontrollin e procedurave të prokurimit tregojnë një mungesë të përgjithshme të një qeverisjeje të mirë në fushën e

⁸ http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPZ_2010_Shqip_391441.pdf

prokurimit. Po ashtu komuna kishte paguar 40 punëtor të arsimit përmes kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, e jo nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Një shumë prej 110.703 euro janë prezantuar në Pasqyrat Financiare si obligime të pa paguara në emër të pagave dhe mëditjeve në departamentin e arsimit. Auditori i Përgjithshëm ka gjetur 10 raste kur kontratat e punës nuk janë përputhur me shumën e paguara. Sipas shënimeve të paraqitura në Pasqyrat Financiare të vitit 2010, komuna ka shpalosur detyrime të pa paguar në vlerë prej 3.488.830 euro. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2011.

Komuna e Prizrenit ka bërë shpenzime enorme në telefon gjatë vitit 2011. Gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2011 Komuna ka harxhuar 25.323 euro për mobil në Vala, dhe 25.554 euro për telefoninë fikse PTK. Vlen të theksohet se vetëm Kryesuesi i Asamblesë, Nijazi Kryeziu gjatë vitit 2011 ka shpenzuar 4.021 euro, apo mesatarisht rreth 340 euro në muaj vetëm në telefon mobil pa llogaritur shpenzimet e tij në atë fiks. Në një muaj të vetëm ai ka shpenzuar gjithsej 970,60 euro (qershor 2011).⁹

Tab.nr.2: Shpenzimet e telefonisë mobile nga zyrtarët komunal-2011

Shpenzimet telefonike - VALA	Shuma (Euro)
Roamingu R. Muja	839,98
Roamingu N. Kryeziu	4.480,06
Kartela grithese të VALA	6.990,00
Të tjera	13.013,20
Total	25.323,24

Komuna e Prizrenit - Konto: 13320 Shpenzimet telefonike VALA

Ndërkaq edhe për telefoni fikse janë shpenzuar 25.554 euro gjatë vitit 2011, që në total nënkuptojnë se Komuna e Prizrenit ka shpenzuar mbi 50 mijë euro vetëm në telefon gjatë një viti.

Tab.nr.3: Shpenzimet e telefonisë fikse 2011 sipas njësive komunale

Telefoni PTK - me fatura	Shuma (Euro)
Biblioteka	453,28
Teatri	308,65

⁹ Tabela e shpenzimeve të buxhetit të KK Prizren, dokumenti me shifër: Konto 13320 Shpenzimet tjera telefonike_Vala 900, Periudha 01.01.2011-31.12.2011, lëshuar nga Drejtoria e Financave të Prizrenit

Administrata	12.351,84
Shërbimet publike	481,27
Bujqësia	150,32
Financat	2.508,26
Asambleja	3.816,14
Zjarrfikësi	1.174,52
R. Ademi	2.967,61
Z. V. Korishë	45,57
ZLK sipas thesarit	1.165,85
Të tjera	130,94
Total	25.554,25

Komuna e Prizrenit - Konto: 13250 Telefoni PTK - me fatura

Komuna ka bërë shpenzime enorme edhe për dreka zyrtare. Gjatë vitit 2011 janë shpenzuar gjithsej 32.580 euro. Madje për ministrat e Qeverisë së Kosovës dreka ka kushtuar më shumë se sa për Kryeministrin e Turqisë. Dreka zyrtare për ministren Mimoza Kusari (më datë 03.08.2011) ka kushtuar 445 euro, ndërkaq dreka për Kryeministrin e Turqisë 340 euro (04.02.2011). Dreka më e shtrenjtë është ajo me përshkrimin 'dreka zyrtare për arsimin' që ka kushtuar 17.300 euro në Vila Park, në Prevallë. Nuk dihet se kush kanë qenë të ftuar në këtë drekë të shtrenjtë dhe përse shumica e drekave janë ngrënë në restorantet më të shtrenjta në Prevallë.¹⁰

Tab.nr.4: Shpenzimet për reprezentacion 2011

Dreka zyrtare 2011	Shuma (Euro)
Dreka zyrtare	31.690,20
Ushqim dhe pije	890,60
Total	32.580,80

Komuna e Prizrenit - Konto: 14310 Dreka Zyrtare


Pjesa më e madhe e mjeteve për dreka zyrtare janë shpenzuar në restorantin "Vila Park" (grafikoni nr.1), kurse 55% e mjeteve për dreka zyrtare janë paguar në muajin korrik (grafikoni nr.2).

¹⁰ Tabela e shpenzimeve të buxhetit të KK Prizren, dokumenti me shifër: Konto 14310 Dreka zyrtare, Periudha 01.01.2011-31.12.2011, lëshuar nga Drejtoria e Financave të Prizrenit

Grafikoni nr.1: Shpenzimet për dreka zyrtare sipas furnitorëve



Grafikoni nr.2: Shpenzimet për dreka zyrtare sipas muajve 2011



Për karburante për vetura Komuna e Prizrenit për vitin 2011 ka shpenzuar 153.346,67 euro, kurse për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve janë shpenzuar 27.915,79 euro. Pjesa më e madhe e karburanteve janë blerë nga Kosova Petrol (grafikoni nr.3).

Grafikoni nr.3: Furnizimi me karburanteve sipas operatorëve ekonomik 2011



Gjatë vitit 2011 komuna ka blerë 4 vetura që kanë kushtuar gjithsej 80.800 euro: një Golf (20.800 euro), Volkswagen Polo (14.800), dy Volkswagen Caddy (5.200 euro) dhe Volkswagen Caddy (37.973 euro). Mbetet e pa qartë përse dy veturat e fundit janë të të njëjtës markë kurse kanë çmime që dallojnë shumë.

Tab.nr.5: Blerja e automjeteve dhe doganimi - 2011

Automjete 2011	Shuma (Euro)
Blerje e veturave	78.773
Doganimi	2.026
Total	80.800

Komuna e Prizrenit - Konto: 31700 Automjete

4. Arsimi

Komuna e Prizrenit ka një çerdhe dhe gjithsej 27 objekte parashkollore, kurse numri i përgjithshëm i fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor për vitin 2011/2012 ishte 1.304. Prizreni ka 63 edukatorë që kujdesen për këta fëmijë, që mesatarisht i bie një edukator për 21 fëmijë. Numri i edukatorëve është dukshëm më i vogël se sa në disa komuna të tjera si për shembull Gjakova që ka 82 edukatorë apo një edukator për 15 fëmijë.¹¹ Komuna e Prizrenit ka 71 shkolla për nivelin arsimor të arsimit fillor dhe arsimit të ulët të mesëm. Në këtë nivel të arsimit, Komuna e Prizrenit gjatë vitit 2010/2011 kishte gjithsej 27.513 nxënës dhe 1.555 mësimdhënës, me një përpjesëtim prej 18 nxënësish për një mësimdhënës.

Sa i përket arsimit të mesëm të lartë, Komuna e Prizrenit ka gjithsej 14 shkolla të mesme, me 9.518 nxënës dhe 537 mësimdhënës. Që nga viti 2010 Prizreni ka edhe Universitetin Publik, ku në vitin e parë akademik 2010/11 ishin regjistruar 1.595 studentë.¹² Gjatë vitit 2010 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka investuar 7 milion euro për ndërtimin e shkollave në këtë komunë. Më 2010 janë ndërtuar shkolla të reja në Kojush dhe në Atmaxhe. Mjete janë shpenzuar edhe për shkollën në Nashec dhe Kobajë.¹³ Zhvillimi dhe modernizimi i arsimit ka qenë premtim i Kryetarit Muja

¹¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Arsimit për Çerdhe dhe Parashkollorë 2011/2012

¹² Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Arsimit 2010/2011

¹³ Zyra e Kryetarit të Komunës, Raporti i Punës Janar – Dhjetor 2010

gjatë fushatës zgjedhore 2009, por kjo gjë shumë pak është realizuar, ndërkohë që arsimi vazhdon të vuaj nga politizimi i tepërt.

5. Shëndetësia

Prizreni është ndër qytetet e pakta që ka spitalin regjional, me gjithsej 628 të punësuar, prej tyre 240 mjekë specialistë. Përveç spitalit regjional, Prizreni ka edhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare si dhe 33 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ka qenë po ashtu një ndër premtimet e kryetarit aktual, por një gjë e tillë shumë pak është realizuar. Gjatë vitit 2010 është bërë ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen 'Bajram Curr', si dhe dy ambulanca të reja janë ndërtuar në fshatin Poslishtë dhe Pallnjan. Po ashtu gjatë vitit 2010 disa ambulanca janë pajisur me kompjuter si dhe është blerë një automobil për nevojat e stafit shëndetësor që punojnë nëpër fshatra. Gjatë vitit 2010 janë punësuar edhe 15 mjekë, 2 infermierë dhe 1 punëtor teknik. Kontrollimet sistematike të nxënësve të klasave të para, të pesta dhe të nënta kanë vazhduar që nga viti 2008.

6. Administrata komunale

Në bazë të analizave MAPL-së¹⁴ kapacitetet e komunës së Prizrenit janë të nivelit të mesëm dhe atij bazik. Vlerësimet tregojnë se kapacitetet e nivelit të bazik janë shumë afër nivelit të ulët dhe kjo e ulë pak nivelin e mesëm zotërues. Zotërimi i nivelit të mesëm nuk është i mjaftueshëm për arritjen e synimeve për një administratë komunale moderne dhe profesionale.

Një dukuri tjetër e pranishme në administratën komunale të Prizrenit është angazhimi i praktikantëve, të cilët fillimisht angazhohen për 6 muaj, mirëpo kjo praktikë më pas zgjatet edhe për gjashtë muaj të tjerë, dhe ka raste kur praktikantët shërbejnë 1 deri në 2 vite brenda administratës komunale, duke ia mohuar këtë të drejtë studentëve dhe të rinjve të tjerë.

¹⁴ <http://www.mapl-ks.org/repository/docs/Prizren.pdf>

7. Transparenca dhe ligji për vetëqeverisje lokale

Në fillim të mandatit kryetari Muja ka emëruar nënkryetarin e dytë nga radhët e komunitetit shumicë, vetëm sa për të përmbushur kërkesat e koalicionit të lidhur me AKR-në. Mirëpo presioni i medieve, shoqërisë civile dhe MAPL-së ka bërë që Muja të tërheq këtë vendim dhe "nënkryetarin e dytë" ta emërojë si këshilltar të kabinetit të tij.

Kryetari Ramadan Muja në disa raste ka marrë vendime që janë në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, sikur që është rasti i bartjes së 22 hektarëve të komunës në pronësi të Universitetit të Prizrenit si dhe nënshkrimi i buxhetit të rishikuar komunal 2010 pa debat paraprak në Kuvendin e Komunës.

Për shkak të shkeljeve ligjore kryetari Muja dhe disa drejtorë janë nën hetime të Prokurorisë së EULEX-it. Prokuroria e misionit evropian për sundim të ligjit është duke kryer hetime penale ndaj kryetarit të komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, kryesuesit të KK-së, Nijazi Kryeziu, drejtorit të Urbanizimit, Sadik Paçarizi, ish-u.d. së drejtorit të Gjeodezisë, Avni Ademaj, ish-drejtorit të Gjeodezisë, Kadri Ukimeri dhe drejtorit aktual të Gjeodezisë, Abdullah Tejeci.

Ramadan Muja, Nijazi Kryeziu, Sadik Paçarizi e Avni Ademaj dyshohet se kanë shpërdoruar pozitën zyrtare dhe kanë tejkualuar kompetencat gjatë dhënies në shfrytëzim të ngastrës kadastrale për Qendrën Edukative Arsimore "Gulistan".

Ndërsa Sadik Paçarizi dyshohet se në cilësinë e drejtorit të Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor ka shpërdorur detyrën zyrtare dhe kompetencat gjatë dhënies në shfrytëzim të tokës komunale për fabrikën e çokollatës NTP "Kamila".

Akuzat ndaj Ramadan Mujës, Kadri Ukimerit, Avni Ademajt dhe Abdullah Tejecit kanë të bëjnë me shpërdorimin e pozitës zyrtare gjatë shkëmbimit të ngastrave kadastrale me individin Hasan Kabashi, derisa Kadri Ukimeri, Avni Ademaj dhe Abdullah Tejeci akuzohen se nuk e kanë kryer detyrën e tyre zyrtare me mos ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të datës 26 maj 2006.

Ndërkaq pika e tretë e akuzës është e drejtuar vetëm kundër kryetarit Ramadan Muja, po ashtu për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe tejkalim kompetencash për lëshimin e konkluzionit në bazë të cilit ka ndaluar ekspertët kadastralë të komunës që të marrin pjesë në seancat gjyqësore dhe të japin ekspertizën e tyre.

Pos hetimeve të Prokurorisë ka zyrtarë të lartë të qeverisë komunale të emëruar nga kryetari Muja në poste udhëheqëse drejtorish që aktualisht ndodhen në bankën e të

akuzuarve në gjykatë, ku aktakuza e Prokurorisë së Qarkut kundër Nexhat Çoçës, ish-koordinatorit për shkolla të mesme e të mesme të ulëta – tani drejtor i Arsimit, Nezir Osmanit, zyrtar për buxhet dhe Reshit Kushajt, zyrtar për tri nivele të arsimit në Drejtorinë komunale të Arsimit në Prizren ka të bëjë me akuzën për shpërdorim të detyrës zyrtare, tejkallim të kompetencave dhe mos përmbushje të detyrave zyrtare, me ç'rast dyshohet se kanë dëmtuar pronarin e firmës transportuese NTSH "Shpejtimi", Ekrem Veselaj për shumën prej mbi 40 mijë eurosh. Sipas aktakuzës i dëmtuari Veselaj edhe pse i kishte përmbushur kriteret e caktuara lidhur me transportimin e maturantëve të shkollave të mesme të Prizrenit në bregdetin e Shqipërisë në maj të vitit 2009 nuk është përfillur nga zyrtarët e DKA-së, të cilët fitues kanë shpallur disa firma tjera, në mesin e të cilave ka pas operatorë që nuk i kanë përmbushur kushtet e parapara për fitimin e tenderit. Me këtë si bashkekzekutor dyshohet se kanë kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 i KPK-së.

Gjithashtu, dukuria e punësimeve në bazë të përkatësisë partiake është shumë e evidente në komunën e Prizrenit. Madje për shkak të përplasjeve të tilla kryetari Muja ka larguar nga puna Osman Hajdarin, ish-udhëheqës i personelit në komunën e Prizrenit, i cili për më tepër se gjashtë muaj nuk ka mundur të kthehet në vendin e tij të punës edhe pse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM) kishte obliguar komunën e Prizrenit për një gjë të tillë. Hajdari e pat konsideruar këtë si hakmarrje personale të kryetarit të komunës ndaj tij. Pas nëntë muajsh ai është kthyer në punë dhe kompensuar.

8. Puna e Kuvendit Komunal

Pushteti lokal në Prizren gjatë mandatit 2009-prezent është ballafaquar me telashe të shumta edhe në funksionimin e legjislativit lokal. Përplasjet ndërmjet pozitës dhe opozitës kanë shtyrë këtë të fundit që për muaj të tërë të bojkotoj seancat e KK-së, gjë që është reflektuar në vendimmarrjen në interes të qytetarëve.

Kuvendi i Komunës ka 41 vende të shpërndara në mesin e dhjetë subjekteve politike; sipas tabelës së mëposhtme. Numri i drejtorive komunale është 13, ndërsa numri i stafit të lejuar është 346.

Tab.nr.7: Përbërja e Kuvendit Komunal të Prizrenit

Përbërja e Kuvendit Komunal të Prizrenit		
Partia	Nr. i ulëseve	Përqindja e votave të fituara
PDK	12	30%
LDK	11	28%
AAK	4	10%
KDTP	3	7%
LDD	3	7%
NDS	2	5%
PD	2	5%
Vakat	1	2%
AKR	2 (1 i pavarur)	5%
ORA	1	2%

Për një kohë të gjatë KK-ja ka dështuar që t'i bindet vendimit të Gjykatës Kushtetuese për ndërrimin e emblemës komunale, e cila në mars të vitit 2010 ishte shpallur si antikushtetuese, pasi që nuk reflekton parimin e barazisë etnike dhe shqetësimet e komuniteteve pakicë nuk janë marrë parasysh. Instancat e larta të qeverisë së Kosovës dhe ato ndërkombëtare disa herë kanë intervenuar për të vënë kushtetutshmërinë në këtë çështje. Pas më shumë se një viti e gjysmë çështja e emblemës është zgjidhur me konsensus të gjerë brenda grupeve parlamentare të KK-së. Megjithatë debati rreth simbolit komunal ka shkaktuar polarizime të skajshme ndërmjet etnive që jetojnë në Prizren, duke vendosur popullatën shumicë në një anë dhe minoritarët në anën tjetër.

KK-ja e Prizrenit në raste të shumta ka bërë shkelje ligjore. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është shkelur në rastin e konstituimit të KK-së, dhënies së betimit të anëtarëve të KK-së, emërimit të nënkryetarit, informimin e publikut, thirrjen e seancës, etj¹⁵. Po ashtu pothuaj çdo vit buxhetor janë shkelur dispozitat e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike me mos paraqitjen e raporteve periodike nga ane kryetarit të komunës.

Sipas nenit 43.2 të LVL-së, Kuvendi i Komunës mbanë së paku dhjetë mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë pjesës së parë të vitit. Gjatë vitit 2011, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka mbajtur 13 mbledhje, 8 prej të cilave në gjashtë mujorin e parë,

¹⁵ KDI - Analiza krahasuese, Puna e KK-ve të rajonit të Prizrenit, tetor 2010-2011

duke e plotësuar kështu normën e paraparë me ligj. Po ashtu edhe komitetet obligative kanë qenë funksionale. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithësej 14 mbledhje gjatë vitit 2011, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur 4 mbledhje. Përgjat një viti Kuvendi i Komunës ka miratur 65 vendime dhe 1 rregullore, kurse Kryetari ka mbajtur 4 takime publike me qytetarët e kësaj komune.¹⁶

¹⁶ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – Raporti i Monitorimit të Komunave të Kosovës 2011

9. Premtimet zgjedhore dhe realizueshmëria e tyre

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune për mandat të dytë, tani kryetari i Komunës z. Ramadan Muja (PDK), elektoratit i kishte prezantuar një program zhvillimor me shumë premtime. Pas regjistrimit të të gjitha premtimeve të bëra gjatë fushata zgjedhore, më 2010 Instituti GAP dhe BIRN i patën shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës së Prizrenit z. Muja, ku ia patën përkujtuar edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë mat progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë premtimet e dhëna nga kryetari Muja. Premtimet e kryetarit Muja dhe koalicionit të tij qeverisës janë përmbushur në mënyrë të pjesshme. Pjesa më e madhe e premtimeve elektorale gjatë fushatës parazgjedhore nuk janë jetësuar.

Premtimet e dhëna	Ecuria e realizimit
Investime prej 170 milionë Euro në katër vitet e ardhshme (prelim i Kryeministrit Thaçit për Prizrenin); Buxhet komunal për katër vitet e ardhshme në vlerë prej 160 milionë, ndër to vetëm rreth 62 milionë do të jenë për investime kapitale;	Premtimi për investimin e 160-170 milionë eurove nuk është përmbushur, ngase në tri vitet e qeverisjes buxheti komunal ka qenë mesatarisht 30 milionë euro, prej tyre investimet kapitale kanë osciluar mes 10 e 13 milionë eurosh, që vërteton se ky premtim nuk është bërë mbi analiza të duhura financiare.
Krijim të vende të reja të punës	Krijimi i vendeve të reja të punës - Ky premtim nuk është përmbushur në masën e pritur nga qytetarët. Madje njëra prej investimeve të huaja, fabrika e çokollatës "Kamila", është përcjellë me aferë, gjë për të cilën prokuroria e

	Qarkut të Prizrenit ka nisur hetime dhe pritet te iniciohet procesi gjyqësor ndaj zyrtarëve komunal nga gjyqtarët e EULEX-it.
Mirëqenie sa më të mirë për qytetarët e komunës	Mirëqenia e qytetarëve të Prizrenit nuk është në nivelin e dëshiruar, ani pse një gjë e tillë ishte premtuar nga kryetari Muja.
Lirimin e zejtarëve të zejeve të rralla nga taksat komunale	Po ashtu lirimi i zejtarëve të zejeve të rralla nga taksat komunale, është aplikuar edhe në mandatet e kaluara, mirëpo nuk është bërë asgjë tjetër në drejtim të përkrahjes së tyre për vazhdim të traditës artizanale në Prizren, ku si pasojë edhe shume zeje tashme janë shuar dhe janë në shuarje e sipër.
Lirimin e investitorëve që do të hapin biznese dhe ulin papunësinë për dy vjet nga taksat komunale	Ulja e taksave dhe tatimeve edhe pse e premtuar nuk është realizuar. Përkundrazi tatimi në pronë është rritur dhe janë shtuar kushtëzimet. Madje edhe propozimet e agjencive ndërkombëtare për ulje të taksave të caktuara nuk është përqafuar nga qeveria komunale.
Zhvillim dhe modernizim të arsimit	Zhvillimi dhe modernizimi i arsimit ka qenë premtim tjetër që nuk është realizuar, ndërkohë që arsimit vazhdon të vuaj nga politizimi i tepërt
Ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore	Cilësia e shërbimeve shëndetësore është në disproporcion me investimet e bëra. Madje këtu kryetari Muja ka favorizuar vazhdimisht institucionin në të cilin është i angazhuar i biri i tij, duke investuar shumë herë në projektet e QKMF-së
Ruajtjen e trashëgimisë kulturore	Dështimi i ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Prizren ka imponuar edhe miratimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, i kundërshtuar nga qytetarët dhe shoqëria civile. Kryetari Muja asnjëherë nuk ka paraqitur një qëndrim publik rreth shqetësimeve të shprehura nga qytetarët dhe

	shoqëria civile. Ndërtimet pa leje dhe uzurpimet në qendrën historike të Prizrenit dëshmojnë për dështimin e pushtetit lokal në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.
Rregullimin e shtratit të lumit	Në fushatën zgjedhore janë premtuar 25 milionë euro investime për lumin Lumbardhë. Deri më tani vetëm një projekt 350 mijë eurosh është realizuar dhe atë fal investimeve të MMPH-së. Komuna nuk ka bërë asgjë në drejtim të rregullimit të shtratit të lumit.
Furnizimin e Prizrenit me ujë të pijshëm nga malet të Sharrit	Po ashtu është premtuar furnizim 24 orë me ujë, gjë që nuk është realizuar përkundër faktit se komuna ka ndarë mjete nga buxheti komunal për investime në gjetjen e burimeve të reja të ujit të pijes.
Zhvillim të hovshëm ekonomik	Kryetari Muja asnjëherë nuk ka prezantuar një strategji të zhvillimit ekonomik lokal. E vetmja platformë mbi të cilën është bazuar qeverisja ka qenë plani afatmesëm buxhetor, ku pozicionet për investime kapitale shpesh herë janë ndryshuar.

10. Burimet

1. Instituti GAP. "Prizreni – Raporti Komunal 2009. Nëntor 2009.
2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm – Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.
3. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm – Raporti i Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.
4. Komuna e Prizrenit – Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.
5. Zyra e Kryetarit të Komunës së Prizrenit – Raporti i Punës Janar – Dhjetor 2010.
6. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Arsimit për Çerdhe dhe Parashkollorë 2011/2012.
7. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Arsimit 2011/2012.
8. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – Raporti i Monitorimit të Komunave të Republikës së Kosovës 2011.
9. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – Raporti i shpenzimeve të buxheteve komunale për vitin 2011.
10. KDI - Analiza krahasuese, Puna e KK-ve të rajonit të Prizrenit, tetor 2010-2011